



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I BASHKISE LEZHE

Bashkia, Lagja "Skënderbeu", Rruga Frang Bardhi, Lezhë – ALBANIA tel/fax: 00 355 215 2270/2570 email : [mayor@lezha.org](mailto:mayor@lezha.org)

**V E N D I M**  
**Nr. 97 Datë 12.12.2011**

**PER**  
**MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

Bazuar ne ligjin nr.8652, date 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nenet 16 e 44, në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ligjin nr.10117 datë 23.04.2009 dhe ligjin nr.10146 datë 28.09.2009 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave Vendore", ligjin nr.10354, datë 18.11.2010 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, në ligjin nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", ligjin nr.10457, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Udhezimin e perbashket të MB dhe MF nr.655/1, datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe raportimit të sistemit të taksës vendore, Udhezimit të DPT nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Kryetari Bashkisë Lezhë, dhe pas diskutimit të antarëve ;

**V E N D O S I**

**I. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, me të gjithë treguesit e saj si më poshtë:**

**A. Taksat Vendore**

Niveli i taksave sipas kategorive dhe nënkategorive, agjenti tatimor, këstet e pagesës, madhësia dhe koha e pagimit përcaktohen si më poshtë:

**1. Taksa vendore mbi biznesin e vogel**

ne 000/leke

N r	Emertimi i aktivitetit	Nivelet e xhiros						
		Deri 2000	2000- 3000	3000- 4000	4000- 5000	5000- 6000	6000- 7000	7000- 8000
1	Shitje me pakice & shumice	27,5	52,8	69,3	85,8	102,3	118,8	135,3
2	Prodhim	25,3	49,5	66	82,5	99	115,5	132

3	Sherbime	22	47,3	63,8	80,3	96,8	113,3	129,8
4	Profesione te lira	33	58,3	74,8	91,3	107,8	124,3	140,8
5	Ambulant	5,5	-	-	-	-	-	-

## 2. Taksa vendore per automjetet e transportit te udhetareve

ne 000/ leke

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 5 vende	19,25
2	Automjete 6-9 vende	38,5
3	Automjete 10-25 vende	44
4	Automjete 26-42 vende	49,5
5	Automjete mbi 42 vende	52,8

## 3. Taksa vendore per automjetet e transportit të mallrave

ne 000/leke

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 2 ton	30,8
2	Automjete 2-5 ton	44
3	Automjete 5-10 ton	52,8
4	Automjete 10-16 ton	55
5	Automjete mbi 16 ton	82,5

### 3.1. Afatet e pagesës

- 3.1.1. Kësti parë jo më vonë se data 20 prill
- 3.1.2. Kësti dytë jo më vonë se data 20 korrik
- 3.1.3. Kësti tretë jo më vonë se data 20 tetor
- 3.1.4. Kësti katert jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.
- 3.1.5. Kur afati i fundit i pagesës së këstit bie ditë pushimi apo ditë feste, atëherë si ditë të fundit të pagesës së këstit do të merret dita e parë e punës pas ditës së pushimit.

### 3.2. Lehtësirat fiskale

- 3.2.1. Taksa paguesit të cilët paguajnë brenda datës 20 prill të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor për taksën vendore mbi biznesin e vogël, përfitojnë si kusht lehtësues reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.

### 3.3. I ngarkuar per vjeljen e taksës

- 3.3.1. Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

## 4. Taksa mbi pasuritë e paluejtëshme (taksa mbi ndertesat)

- 4.1. Llogaritjet mbi bazën e sipërfaqes së ndërtimit në pronësi të taksapaguesit, përfshirë sipërfaqen mbi e nën tokë ose për çdo kat.

Lek/m<sup>2</sup> ne vit

Nr	Kategoria / Nenkategoria	Niveli i Takses
1	Ndertesa banimi	

	Ndertuar para vitit 1993	10
	Ndertuar gjate ose pas vitit 1993	12
2	Ndertesat tjera	
	Per cdo njësi tregtimi, shërbimi, ndërtimi, profesione të lira, administrative, social kulturore, arsimore	150
	Ndertesat për aktivitetet prodhuese e përpunuese,	30
	Ndertesat në shërbim të OJF- ve	30

- 4.2. Sipërfaqja në pronësi të çdo subjekti tatimpagues përcaktohet mbi bazën e dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për objektet që mungon një dokumentacion i tillë kjo sipërfaqe përcaktohet me komision të posaçëm, të ngritur me urdhër të kryetarit të Bashkisë.
- 4.3. Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.
- 4.4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.  
Per biznesin likuidimi behet brenda dates 20 Prill.  
Per familjet likudimi behet brenda dt. 31 Gusht, pas kesaj date Bashkia kerkon mbledhjen e takses ne menyre te detyrueshme konform kuadrit ligjor; ne rast se nuk paraqitet dokument mbi pronesine, taksa e ndertesës paguhet si minimum i sipërfaqes se baneses prej 100 m<sup>2</sup>.

#### **Shënim :**

- a.** Ndërtesat për tregeti dhe shërbime do të kuptojmë të gjitha ndërtesat -hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familjar, agjenci shërbimesh, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, bankat, zyrat, farmaci, klinika private, spitale private, maternitete private, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve, njësi tregtare dhe shërbimi artizanale qe perdoren si marangoz, këpucar, orëndreqës, rrobaqepes, ndërtesat qe perdoren si ambjente pune per profesionet e lira si noter, avokat, dentist, perkthyes, inxhinier, mjek, topograf, farmacist, ekspert kontabel, kontabel miratuar, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektues etj.
- b.** Ndërtesat prodhimi do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim druri, duralumini, letre, kartoni, metalesh, tapicerie, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe ndertimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, prodhim vezesh, prodhim përpunim mishi e produkteve blegtorale, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, nafte etj, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produkteve farmaceutike dhe të ngjashme me to. c- Ndërtesat për institucion arsimor jopublik, konvikt private etj do të kuptojmë të gjitha ndërtesat per shkollat, kopshtet, cerdhe, qendra kulturore, qendra sociale, konviktet etj. d-
- c.** Ndërtesat e OJF, fondacionet do te kuptojme ndërtesat qe përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare.
- d.** Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve fizike ose juridike, Taksa e Pasurisë nuk perlllogaritet si ndërtesat banimi por perlllogaritet dhe paguhet si pika 2 “ndërtesat tjera” e tabelës se mesiperme, sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë ne varesi te sipërfaqes se deklaruar si seli.

#### **5. Taksa e fjetjes në hotel.**

- 5.1. Masa e kësaj takse është 5% e çmimit të fjetjes.  
 5.2. Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

**6. Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndertimet e reja**

- 6.1. Përcaktohet me koeficient në përqindje mbi bazen e vlerës në lekë të ndertimit të ri.  
 6.2. Kjo takse paguhet me një këst të vetëm në momentin e paisjes me leje nga investitori.  
 6.3. Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Lezhë.

<b>Nr</b>	<b>Kategoria /Nenkategoria</b>	<b>Koeficienti në % ndaj vlerës së ndertimit</b>
1	Objekte banimi, administrative, shërbimi etj, pavaresisht nga vendodhja në territorin e bashkisë.	3
2	Infrastrukturë, rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefoni dhe çdo investim tjetër publik.	2

**7. Taksa për zënien e hapësirave publike**

- 7.1. Niveli i taksës për zënien e hapësirës publike, për qëllime biznesi në hapësira publike të administruara nga Bashkia Lezhë të jetë 99 lekë/m<sup>2</sup>/në muaj.  
 7.2. Kjo taksë llogaritet nga Drejtoria e Tatimit Taksave mbi sipërfaqen në meter katror që do t'i jepet për përdorim, pasi të jetë aprovuar kërkesa e subjektit dhe t'i jetë dhënë leja e shfrytëzimit të hapësirës publike.  
 7.3. Pagesa e kësaj takse bëhet e plotë vjetore, nga momenti i dhënies së lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe lidhjes së kontratës me Bashkinë Lezhë.  
 7.4. Ngarkohet për vjeljen e kësaj takse Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.

**8. Taksa e tabelleve**

- 8.1. Përcaktohet si detyrim vjetor në lekë i subjekteve mbi bazen e kategorive dhe nenkategorive të mëposhtme:

Ne lekë

<b>Nr</b>	<b>Kategoria /Nenkategoria</b>	<b>Niveli i Takses</b>
1	Tabelë për qëllime identifikimi pamvaresisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	120 /lek /vit
2	Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe	22.500 /lekë/m <sup>2</sup> /vit

	elektronike, me sipërfaqe deri në 18 m <sup>2</sup>	
3	Tabelë për qellime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike, me sipërfaqe më të mëdha se 18 m <sup>2</sup>	405.000 lekë/vit/tabelë
4	Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj	1.000/lekë/m <sup>2</sup> /ditë

Subjekti paraqet kërkesen në bashki për vendosjen e tabelave për qellime reklamimi të thjeshta ose elektronike, Drejtoria Urbanistike miraton ose jo lejen ku specifikohet vendndodhja dhe sipërfaqja e caktuar, kjo leje i dergohet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila llogarit detyrimet dhe mbasi bëhet pagesa e plote, subjekti merr lejen të firmosur edhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe lidh kontratën për vendosjen e reklamave.

- 8.2. Detyrimi për tabelën paguhet brenda datës 20 Prill të vitit fiskal, ose në momentin e hapjes së aktivitetit.
- 8.3. Detyrimi për reklamen paguhet në një kest në momentin e marrjes së lejes për vendosje.
- 8.4. Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### **9. Taksa e regjistrimit të pasurive të paluejtëshme.**

- 9.1. Niveli i kësaj takse mbetet në kufijte e përcaktuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”
- 9.2. Agjenti tatimor për vjeljen e kësaj takse është ZRPP Lezhë.
- 9.3. Ngarkohet Drejtoria e Taksave të bëjë rakordimet me ZRPP Lezhë për planifikimin dhe vjeljen e saj.

#### **10. Taksa për tavolina të vendosura nga baret e restorantet në hapësira publike pranë ndërtesave ku ato ushtrojnë aktivitetin.( taksë e përkohshme)**

- 10.1. Niveli i taksës është në masën 300 lekë/tavolinë të vendosur/ditë.
- 10.2. Kjo taksë llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pasi të jetë aprovuar kërkesa e subjektit dhe t’i jetë dhënë leja për shfrytëzim nga Bashkia lezhë për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe lidhjes së kontratës me Bashkinë Lezhë.
- 10.3. Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### **B. Tarifat vendore**

Llojet, kategoritë, nenkategoritë, baza, kestet, koha e pagesës dhe organi që ngarkohet për mbledhjen e tyre përcaktohen si më poshtë:

##### **1. Tarifa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave (institucione, biznes, familje)**

- 1.1. Tarifa e pastrimit paguhet nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lezhë.

<b>Nr</b>	<b>Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategoritë</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>Tarifa</b>
<b>A</b>	<b>Per cdo njësi tregtare</b>		
	Biznes i madh	Lek/vit/njësi	25.000
<b>B</b>	<b>Për çdo njësi shërbimi</b>		
	Biznes i madh	Lek/vit/njësi	35.000
<b>C</b>	<b>Për çdo njësi prodhimi</b>		
	Biznes i madh	Lek/vit/njësi	40.000
<b>D</b>	<b>Per çdo subjekt ndërtimi</b>	Lek/vit/njësi	20.000
	Subjektet e ndërtimit (te regjistruar pranë Bashkisë Lezhë apo në qendra të tjera vendore) paguajnë tarife shtese për cdo kantier ndërtimi të hapur brenda territorit në juridiksion të Bashkisë Lezhë në raport me kohezgjatjen e kantjerit dhe vlerës së investimit si më poshtë		
1	Per vlera investimi deri në 5.000.000 leke	Leke/kantier/vit	20.000
2	Per vlera investimi 5.000.001-15.000.000 leke	Leke/kantier/vit	40.000
3	Per vlera investimi 15.000.001-25.000.000 leke	Leke/kantier/vit	60.000
4	Per vlera investimi 25.000.001-50.000.000 leke	Leke/kantier/vit	70.000
5	Per vlera investimi 50.000.001-100.000.000 leke	Leke/kantier/vit	80.000
6	Per vlera investimi 100.000.001-200.000.000 leke	Leke/kantier/vit	100.000
7	Per vlera investimi mbi 200.000.000 leke	Leke/kantier/vit	150.000
<b>E</b>	<b>Institucione administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, organizate jofitimprurëse, kulti, etj</b>		
1	Institucione administrative publike	Leke/m <sup>2</sup> /vit	30
2	Universitete, Shkollat, kopshtet apo cerdhet, konvikte, kolegje, institucione kulti, etj		
2.a	Biznes i madh	Lekë/vit	30.000
2.b	Shtetërore	Leke/m <sup>2</sup> /vit	30
2.c	Institucione kulti	Leke/m <sup>2</sup> /vit	15
3	Spitale, maternitete, klinika mjekësore, klinika dentare, laboratore etj të ngjashme me to.		
3.a	Biznes i madh	Lekë/vit	30.000
3.b	Shtetërore	Leke/m <sup>2</sup> /vit	30
4	Organizata jofitimprurëse	Lekë/vit	5.000

1.2. Pagesa për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrim vjetor, likuidimi bëhet deri më datën 20 Prill.

Shënim :

**a.** Për nënkategorinë “çdo kantier ndërtimi”, llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë Bashkisë të kërkesës për leje shfrytëzimi. Drejtoria e Urbanistikës përllëgarit detyrimin, i cili paguhet përpara marrjes së lejes shfrytëzimit.

1.3. Kategoria “familjarë”.

Ne lekë

Nr	Tarifat e shërbimeve për kategorinë familjare	Njesia e matjes	Tarifa vjetore	Lehtësi fiskale (10%)	Lehtësi sociale
1	Për shërbimin e pastrimit	lek/vit/familje	1.500	150	750
2	Për shërbimin e gjelbërimit	lek/vit/familje	400	40	200
3	Për shërbimin e ndricimit	lek/vit/familje	300	30	150
	<b>Totali</b>		<b>2.200</b>	<b>220</b>	<b>1.100</b>

- 1.3.1. Tarifat familjare paguhen nga të gjithë familjet e rregjistruara ne rregjistrin e gjendjes civile te Bashkise Lezhë. Familjet qe i paguajne keto tarifa deri me date 30 qershor perfitojne zbritje prej 10%.
- 1.3.2. Për taksapaguesit familjare, të cilët nuk i kane shlyer tarifate deri me datë 31 gusht, Bashkia kërkon pas ketij afati mbledhjen e ketyre tarifave ne menyre te detyrueshme konform kuadrit ligjor.
- 1.3.3. Kategorite e familjeve te tabelës meposhtme perfitojne lehtësi sociale prej 1,100 lekesh në se do të vertetohet gjendjen e tyre me kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë ne ngarkim (mbi 22 vjec) përvec bashkëshortit ose bashkëshortes sipas çertifikatës familjare. Ato duhet te dorezojne pranë zyrove të Departamentit te te Ardhurave kopje te librezës se pensionit, librezes dhe statusit te invalidit të punës te grupit pare dhe te dyte, statusit te të verbërit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik dhe vërtetimin nga Drejtoria e Ndhimes ekonomike për përfituesit e ndihmës ekonomike.
- 1.3.4. Kategoritë përfituese të lehtësive sociale :
- 1.3.4.1. Pensionistët (kryefamiljare)
- 1.3.4.2. Invalidët e perhershem te punës (grupi i pare e dyte- kryefamiljare)
- 1.3.4.3. Përfituesit e ndihmës ekonomike (kryefamiljare)
- 1.3.4.4. Të verbërit
- 1.3.4.5. Të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik
- 1.3.5. Ngarkohet per mbledhjen e kesaj tarife Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

## 2. Tarifa e Gjelbërimit ( institucione, biznes)

- 2.1 Tarifa e gjelberimit paguhet nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lezhë. Nivelet treguese të Tarifës së Gjelberimit janë të shprehura më poshtë per institucionet dhe biznesin e madh.
- 2.2. Detyrimi për tarifen e gjelberimit është vjetor, likuidimi behet deri me daten 20 Prill.
- 2.3. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifes se gjelberimit eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Ne lekë

Nr	Tarifa e gjelbërimit për kategoritë :	Njësia e matjes	Tarifa
A	<b>Njësi tregtare</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	4.000
B	<b>Njesi sherbimi</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	4.000
C	<b>Njesi prodhimi e përpunimi</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	4.000
D	<b>Profesione të lira</b>		

	Biznes i madh	leke/vit/njesi	4.000
<b>E</b>	<b>Njësi ndërtimi</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	10.000
<b>F</b>	<b>Institucione administrative, arsimore, kulturore, shendetsore, sportive organizate jofitimprurse, kulti, etj</b>	leke/vit/njesi	3.000

### 3. Tarifa e ndriçimit (institucione, biznes)

- 3.1. Tarifa e ndriçimit paguhet nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lezhë. Nivelet treguese të Tarifës së ndriçimit janë të shprehura më poshtë për institucionet dhe biznesin e madh.
- 3.2. Detyrimi për tarifen e ndriçimit është vjetor, likuidimi behet deri me datën 20 Prill.
- 3.3. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së ndriçimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore :

Ne lekë

Nr	Tarifa e ndriçimit për kategoritë :	Njësia e matjes	Tarifa
A	<b>Njësi tregtare</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	3.000
B	<b>Njesi sherbimi</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	3.000
C	<b>Njesi prodhimi e përpunimi</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	3.000
D	<b>Profesione të lira</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	3.000
E	<b>Njësi ndërtimi</b>		
	Biznes i madh	leke/vit/njesi	8.000
F	<b>Institucione administrative, arsimore, kulturore, shendetsore, sportive organizate jofitimprurse, kulti, etj</b>	leke/vit/njesi	2.000

### Shënim :

Subjektet e Biznesit të Madh, me xhiro deri në 8 milion lekë, pamvarësisht statusit juridik apo fizik, të trajtohen për detyrimet për keto tarifa ashtu siç trajtohet biznesi i vogël.

### 4. Tarifat e shërbimeve (pastrim, gjelbërim, ndriçim) për kategorinë “biznes i vogël”.

Ne lekë

Nr.	Aktivitetet/Tarifat	Deri në 2000	2000-3000	3000-4000	4000-5000	5000-6000	6000-7000	7000-8000
1.	Shitjet me pakicë	2.750	5.280	6.930	8.580	10.230	11.880	13.530
2.	Njësi Prodhimi	2.530	4.950	6.600	8.250	9.900	11.550	13.200
3.	Sherbime	2.200	4.730	6.380	8.030	9.680	11.330	12.980
4.	Profesione të lira	3.300	5.830	7.480	9.130	10.780	12.430	14.080
5	Ambulantët	550						



- 4.1. Detyrimi paguhet në një kest brenda datës 20 Prill ose në momentin e lindjes fillestare të detyrimit.
- 4.2. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së ndriçimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

**5. Tarifa e parkimit të automjeteve në vendparkimet publike me pagesë.**

Në lekë

Nr	Automjete në shërbimin e transportit publik	Njesia e matjes	Tarifa
1	Autobuza	Lekë/vit	30.000
2	Minibuza	Lekë/vit	20.000
3	Autovetura	Lekë/vit	10.000

Në lekë

Nr	Autovetura jashtë transportit publik	Njesia e matjes	Tarifa
<b>A.</b>	Në sheshin administrativ të qytetit		
1	Për qëndrim deri në 30 minuta.	Orë qëndrimi	Falës
2	Mbi 30 minuta	Orë qëndrimi	30
<b>B.</b>	Në rrugë të tjera	Orë qëndrimi	20
<b>C.</b>	Të rezervuar	Lekë/vit	20.000

51. Për vjeljen e të ardhurave për vendet e rezervuara ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- 5.2. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës, sipas pikave A dhe B, është agjenti tatimor i ngarkuar nga Bashkia Lezhë.

**Shënim :**

Agjenti tatimor i ngarkuar për vjeljen e taksës sipas pikës A dhe B, është i detyruar të monitorojë kohën e qëndrimit të mjeteve.

**6. Tarifa maksimale për transportin e udhëtarve me taksë në zonë urbane nga ora 06:00-21:00.**

- 6.1. Tarifa fillestare për distancën deri në 2 km të jetë 300 lekë. Për çdo udhëtar shtesë nga nisja, shtesa në lekë nga taksisti duhet të jetë 150 lekë.
- 6.2. Tarifa për distancën deri në 14/km të jetë 1.600 lekë ose 114.3 lekë/km.
- 6.3. Tarifa mbi 14 km deri në 30 km të jetë 3.400 lekë ose 118/lekë/km
- 6.4. Tarifa mbi 30 Km të jetë 153 lekë për çdo km

**7. Tarifa maksimale të udhëtimit në zonat jo urbane nga ora 06:00 – 21:00.**

- 7.1. Tarifa fillestare deri në 2 km të jetë 350 lekë. Për çdo udhëtar shtesë aplikohet

50% e tarifës fillestare.

- 7.2. Tarifa deri në 14 km të jetë 1.350/lekë, ose 96.4 lekë/km.
- 7.3. Tarifa mbi 14 km deri 30 km të jetë 2.950 lekë, ose 92/km.
- 7.4. Tarifa mbi 30 km të jetë 133 lekë/km.
- 7.5. Për çdo udhëtim në tarifimin e taksimetrit nga drejtoria e kalibrimin vëndoset tarifa fillestare e udhëtimit deri në 2 km e para plus sipas distancës përshkruar në pikat b,c,d,
- 7.6. Për shërbime të kryera pas orës 21:00 deri në orën 06:00 si dhe në ditët e djela e festa zyrtare çdo tarifë udhëtimit t'i shtohet 10% e vlerës.

## 8. Tarifa për shërbimet administrative:

Në lekë

Nr	Sherbime të Arkives	Njesia e matjes	Tarifa
1	Ekstrakt vendim keshilli e vertetime të arkivit	Lekë/dokument	100
2	Dokument vertetim pronësie	Lekë/dokument	200
3	Vërtetime të çdo lloji të lëshuara nga administrata publike	Lekë/dokument	100

- 8.1. Të gjitha vërtetimet dhe dokumentet e tjera zyrtare për qytetarët lëshohen vetëm pas konfirmimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.
- 8.2. Ngarkohet për vjeljen e kësaj tarifë Drejtoria e Burimeve Njerëzore

## 9. Tarifë shërbimi për strehimin

nr	Lloji i tarifës	Njesia e matjes	Tarifa
1	Tarifë shërbimi për strehimin	Lekë/aplikim	200

- 9.1. Të gjitha vërtetimet dhe dokumentet e tjera zyrtare për qytetarët lëshohen vetëm pas konfirmimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.
- 9.2. Ngarkohet për vjeljen e kësaj tarifë Drejtoria e Shërbimeve Publike.

## 10. Tarife shërbimi për tregjet publike

Në lekë

Nr	Tarifat e tregut sipas kategorive	Njesia e matjes	Tarifa
1	Shites artikuj industrial	Lekë/muaj	1.000
2	Shites artikuj ushqimorë	Lekë/ muaj	1.500
3	Shites artikuj bulmeti e mish	Lekë/ muaj	2.000
4	Shites ditore	lekë/m <sup>2</sup> /në ditë	100

- 10.1. Ngarkohet për vjeljen e detyrimeve, agjenti tatimor që ndjek shfrytëzimin e tregut publik, sipas kontratës me Bashkinë Lezhë, në rakordim me drejtorinë e Taksave dhe tarifave Vendore .

## 11. Tarifat e licensave të veprimtarive të transportit

Në lekë

A	Tarifat e licensimit të transportit të udhëtarëve	Njesia e matjes	Tarifa
---	---	-----------------	--------

1	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt qytetese	Leke/5 vjet	40.000
2	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt qytetese	Leke/mjet/vit	1.000
3	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt rrethqytetese	Leke/5 vjet	20.000
4	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt rrethqytetese	Leke/mjet/vit	1.500
5	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese brenda qarkut	Leke/5 vjet	75.000
6	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese brenda qarkut	Leke/mjet/vit	1.500
7	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese ndermjet qarqeve	Leke/5 vjet	75.000
8	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese ndermjet qarqeve	Leke/mjet/vit	1.500
9	Liçense per agjensi transporti udhetaresh dhe taksi brenda vendit	Leke/5 vjet	15.000
10	Liçense per agjensi nderkombetare udhetaresh	Leke/5 vjet	40.000
11	Liçense per transport udhetaresh me taksi	Leke/mjet/5 vjet	20.000
12	Dhënie autorizimi per transport nderqytetas	Lekë/mjet	2.000
<b>B</b>	<b>Tarifat e Liçensimit te Transportit te mallrave</b>		
1	Liçense per transport mallrash per te trete dhe me qera brenda vendit	Leke/5 vjet	40.000
2	Çertifikate per transport mallrash per te trete dhe me qera brenda vendit	Leke	100
3	Çertifikate per transport mallrash per vehte brenda vendit	Leke	100
4	Çertifikate per transport mallrash & udhëtarë	Leke	3.000

11.1. Per vjeljen e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, pas rakorimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore, me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

## 12. Tarifa ne fushen e urbanistikës

Në lekë

<b>Nr</b>	<b>Llojet e tarifave</b>	<b>Njesia e matjes</b>	<b>Tarifa</b>
1	Pranim dosje per shqyrtim per te gjitha llojet e aplikimeve		
2	per nevoja biznesi	Lekë/dosje	5.000
3	per shtepi banimi	Lekë/dosje	2.000
4	për ndryshim destinacioni	Lekë/dosje	2.000
5	Njehsim i dokumenteve me origjinalin	Lekë/dokument	100
6	Per fasaden e objekteve	Lekë/m2	30
7	Kontroll i piketimit te objekteve	Lekë/kontroll	2.000
8	Kontroll pas perfundimit te themeleve	Lekë/kontroll	5.000
9	Kontroll pas perfundimit te karabinase	Lekë/kat	2.000
10	Kontroll mbi sistemimin e ambientit rrethues		3.000
11	Akt kontroll i perfundimit te punimeve për leje perdorimi	Lekë/m2	50
12	Azhornim genplanesh per leje ndertimi	Lekë/m2	40
13	Matje e percaktim i zones se vendndodhjes se objektit, azhornim i genplanit	Lekë/dokument	3.000
14	Azhornime per reklama e zenie hapësirash publike	Lekë/dokument	2.000

12.1. Per vjeljen e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Urbanistikes.

### **13. Tarifa për autorizim për shitje karburanti**

Në lekë

<b>Nr</b>	<b>Llojet e tarifave</b>	<b>Njesia e matjes</b>	<b>Tarifa</b>
	Autorizim shitje karburanti me pakice	Lekë/autorizim	50.000

13.1. Per vjeljen e kesaj tarife ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

### **14. Tarifa për Leje dhe Shërbim Veterinar ( Inspektoriatit Veterinar)**

Në lekë

<b>Nr</b>	<b>Tarifa për leje tregetimi</b>	<b>Njesia e matjes</b>	<b>Tarifa</b>
1	Njesi tregetare mishi	Lekë/vit	11.250
2	Njesi tregtare peshku	Lekë/vit	11.250
3	Automjet për tregtim bulmeti, mishi dhe peshku	Lekë/vit	7.500
4	Magazina frigoriferike per te trete	Lekë/vit	7.500
5	Fabrike sallami	Lekë/vit	15.000
6	Stabiliment peshku	Lekë/vit	22.500
7	Pike grumbullimi lekura	Lekë/vit	11.250

8	Njesi punishte bulmeti	Lekë/vit	7.500
---	------------------------	----------	-------

14.1. Per vjeljen e kesaj tarife ngarkohet Sektori i Inspektoriatit Veteriner pas rakorimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore, me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

## 15. Tarifa sherbimi per institucionet e varesise:

Në lekë

Nr	Tarifat sipas kategorive	Njësia e matjes	Tarifa
<b>A</b>	<b>Përdorimi i ambjenteve në Pallatin e Kulturës</b>		
1	Salla e leksioneve	Lekë/orë përdorimi	3.000
2	Salla e madhe e shfaqjeve	Lekë/orë përdorimi	20.000
3	Per shfaqjet të organizuara nga institucioni për publikun	Lekë/person	200
4	Përdorimi i sallave për zhvillime provash	Lekë/orë përdorimi	300
5	Salla e Galerisë së arteve për ekspozita	Lekë/ditë përdorimi	3.000
6	Salla e Galerisë së arteve, Për piktoret e rinj e talentet e reja	Lekë/ditë përdorimi	1.000
<b>B</b>	<b>Bibloteka Publike e Qytetit</b>		
1	Holli në katin e dytë	Lekë/ditë përdorimi	3.000
2	Hapje kartelexuesi të rregullt	Lekë/kartelë	100
3	Hapje kartelexuesi për fëmijet		falas
<b>C</b>	<b>Muzeu &amp; Memoriali</b>		
1	Për të rritur	Lekë/biletë	100
2	Për fëmijët	Lekë/biletë	50
<b>D</b>	<b>Klubi Sportiv Besëlidhja</b>		
<b>1</b>	Ndeshje kombëtare		
2	Tribuna A e B ( e mbuluar)	Lekë/biletë	200
3	Tribuna A e B ( e pambuluar)	Lekë/biletë	150
4	Tribuna perballë	Lekë/biletë	100
5	Ndeshje ndërkombëtare		
6	Tribuna A e B ( e mbuluar)	Lekë/biletë	500
7	Tribuna A e B ( e pambuluar)	Lekë/biletë	400
8	Tribuna perballë	Lekë/biletë	300
9	Per dhenie në shfrytëzim të mjediseve sportive	Lekë/aktivitet	50.000

15.1. Strukturat e ngarkuara për vjeljen e këtyre tarifave janë drejtuesit e Institucioneve vartëse, si dhe drejtorja e finances për evidentim e kontroll.

## 16. Të ardhura nga qeratat e objekteve

16.1. Për dhënien me qera të objekteve pronë e Bashkise në zbatim të VKM nr.1712, datë 24.12.2008, çmimi të jetë 350/lekë/m<sup>2</sup>.

**C. Dispozita te veçanta**

1. Kur e miraton Këshilli i Bashkisë mbledhjen e një takse apo tarife vendore me agjent fiskal, të propozuar nga Kryetari i Bashkisë, agjenti fiskal të shpërblehet në përqindje mbi vlerën e arkëtuar, në masën e përcaktuar me Vendim të Këshillit Bashkisë
  2. Per subjektet qe rregjistrohen per here te pare gjate vitit ushtrimor, niveli i takses do te jete proporcionalisht me pjesen e mbetur te vitit.
- II.** Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë
- III.** Policia Bashkiake ngarkohet te mbeshtese, sipas rregullave te percaktuara ligjore dhe udhëzimeve të nxjerra nga Bashkia për zbatimin e këtij vendimi, inspektoret e të gjithë Drejtorive përkatëse për realizimin e te ardhurave nga taksat e tarifate vendore.
- IV.** Ngarkohet Bashkia Lezhe te nxjerre udhezimin per zbatimin e ketij vendimi, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.
- V.** Ky vendim i shtrin efektet finaciare nga data 01 janar 2012 e në vazhdim.
- VI.** Vendimet e Këshillit të Bashkisë Lezhë, nr.111, datë 27.12.2010 shfuqizohet.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI  
AGOSTIN MARKU**